

Statistikat e transportit*

Prill 2022

Tiranë, më 27 Maj 2022: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Prill 2022 është 425,8 mijë ton, duke u ulur me 5,7 %, krahasuar me Prill 2021.

Në katërmujorin e parë të vitit 2022, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 1.426,3 mijë ton, duke u ulur me 6,9 %, krahasuar me katërmujorin e parë të vitit 2021.

Në muajin Prill 2022, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.658 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 28,9 %, krahasuar me Prill 2021.

Në katërmujorin e parë të vitit 2022, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 6.738 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 35,4 %, krahasuar me katërmujorin e parë të vitit 2021.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Transporti i mallrave		
	Me det / ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër / ton *
Prill 2021	451.551	2.333	160,8
Prill 2022	425.772	1.658	174,0
Ndryshimi vjetor (%)	-5,7	-28,9	8,2
Janar-Prill 2021	1.532.002	10.436	610,3
Janar-Prill 2022	1.426.327	6.738	656,3
Ndryshimi vjetor (%)	-6,9	-35,4	7,5

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në muajin Prill 2022, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 174,0 ton, duke u rritur me 8,2 %, në krahasim me Prill 2021.

Në katërmujorin e parë të vitit 2022, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 656,3 ton, duke u rritur me 7,5 %, krahasuar me katërmujorin e parë të vitit 2021.

Në Prill 2022, numri i fluturimeve të kryera është 2.966, duke u rritur me 2,5 herë, në krahasim me muajin Prill 2021.

Për publikim 27/05/2022

Vijon

Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Prill 2021	14	1.204	4.294
Prill 2022	17	2.966	14.973
Ndryshimi vjetor (%)	21,4	146,3	248,7
Janar-Prill 2021	14	4.342	16.724
Janar-Prill 2022	17	9.350	41.441
Ndryshimi vjetor (%)	21,4	115,3	147,8

*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licensuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në Prill 2022, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 53.925 pasagjerë. Krahasuar me Prill 2021, ky tregues është rritur me 77,3 %. Në katërmujorin e parë të vitit 2022, kanë udhëtuar me linjë detare 175.274 pasagjerë, duke u rritur me 47,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Në Prill 2022, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë hekurudhore është 1.917 pasagjerë. Krahasuar me Prill 2021, ky tregues është rritur me 4,6 herë. Në katërmujorin e parë të vitit 2022, kanë udhëtuar me linjë hekurudhore 5.744 pasagjerë, duke u rritur me 3,6 herë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Në muajin Prill 2022, transporti ajror i pasagjerëve zë 87,4 % të transportit gjithsej.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në Prill 2022 është 386.444 pasagjerë, duke u rritur me 3,8 herë, krahasuar me Prill 2021. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në katërmujorin e parë të vitit 2022 është 1.147.270 pasagjerë, duke u rritur me 3,3 herë, krahasuar me katërmujorin e parë të vitit 2021.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Prill 2021	414	30.413	101.354
Prill 2022	1.917	53.925	386.444
Ndryshimi vjetor (%)	363,0	77,3	281,3
Janar-Prill 2021	1.596	118.715	342.804
Janar-Prill 2022	5.744	175.274	1.147.270
Ndryshimi vjetor (%)	259,9	47,6	234,7

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Prill 2022, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 119,9 mld lekë ku 50,0 % e tyre u transportua me det.

Në katërmujorin e parë të vitit 2022, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 447,3 mld lekë ku 51,0 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave

Në Prill 2022, mallrat e eksportuara me det zënë 55,9 %, me tokë 37,3 % dhe me ajër 0,2 %. Mallrat e eksportuara me tokë në Prill 2022 janë rritur me 32,9 %, krahasuar me Prill 2021.


Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Eksport (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me tokë	Me ajër	Të tjera
Prill 2021	14.777	-	11.793	80	2.042
Prill 2022	23.493	-	15.675	93	2.788
Ndryshimi vjetor (%)	59,0	0,0	32,9	16,1	36,5
Janar-Prill 2021	61.053	1	39.692	266	7.904
Janar-Prill 2022	90.994	-	56.393	387	14.288
Ndryshimi vjetor (%)	49,0	-100,0	42,1	45,4	80,8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në katërmujorin e parë të vitit 2022, mallrat e eksportuara me det zënë 56,1 %, me tokë 34,8 % dhe me ajër 0,2 %. Mallrat e eksportuara me tokë janë rritur 42,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Prill 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Importet e mallrave

Në Prill 2022 mallrat e importuara me det zënë 46,8 %, me tokë 45,0 % dhe me ajër 2,0 %.

Mallrat e importuara me tokë në Prill 2022 janë rritur me 11,6 %, krahasuar me Prill 2021.


Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Import (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me tokë	Me ajër	Të tjera
Prill 2021	28.068	325	31.401	2.501	633
Prill 2022	36.455	0	35.047	1.578	4.781
Ndryshimi vjetor (%)	29,9	-100,0	11,6	-36,9	655,3
Janar-Prill 2021	104.091	1.244	108.074	7.381	4.302
Janar-Prill 2022	137.098	341	123.263	6.651	17.852
Ndryshimi vjetor (%)	31,7	-72,6	14,1	-9,9	314,9

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në katërmujorin e parë të vitit 2022, mallrat e importuara me det zënë 48,1 %, me tokë 43,2 % dhe me ajër 2,3 %. Mallrat e importuara me tokë janë rritur me 14,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Fig. 2 Struktura e impoeteve sipas mënyrës së transportit, Prill 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transporti tokësor: Çdo lëvizje e mallrave duke përdorur një mjet rrugor në një rrjet të caktuar rrugor.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues dhe përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash